



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian
Mbledhja nr. 16
Prishtinë, më 19. 07. 2011, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Lutfi Haziri, Xhavit Haliti, Sasha Milosavljeviq, Vjosa Osmani, Blerta Deliu – Kodra, Alma Lama, Blerim Shala, Suzana Novobërdali dhe Albert Kinolli.

Munguan: Fatmir Limaj.

Me ftesë: z. Bajram Rexhepi – Ministër i Punëve të Brendshme

Stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha – koordinatore, Safet Beqiri – zyrtar për integritet evropian.

Pjesëmarrës të tjerë: Nexhat Shatri – Zyra e Presidentit, Sanije Berisha, Blerim Vela – OSBE, Besnik Ramadanaj – KDI dhe Arban Abrashi, Venera Mjekiqi – Kuvendi.

Mbledhjen e kryesoi Lutfi Haziri – kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

R E N D I I D I T Ë S

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 5. 7. 2011;**
- 3. Raportim i ministrit të Punëve të Brendshme, z. Bajram Rexhepi;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-011 për organizimin sindikal në Kosovë, me**

- amendamentet e komisionit funksional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-014 për kontabilitet, raportim financiar dhe Auditim, me amendamentet e komisionit funksional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
 6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-26 për markat tregtare, me amendamentet e komisionit funksional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
 7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-29 për patenta, me amendamentet e Komisionit Funksional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
 8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-28 për dizajnin industrial, me amendamentet e komisionit funksional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
 9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-22 për përdorimin civil të eksplozivëve, me amendamentet e komisionit funksional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
 10. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/ 249/L-013 për kadastrë, me amendamentet e komisionit funksional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
 11. Informatë shpeshë për rishqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, me amendamentet e komisionit funksional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
 12. Diskutim lidhur me hartimin e raportit të parë të Progresit të Planit të Veprimit të Kuvendit për integrim evropian për vitin 2011;
 13. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të 5. 7. 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së datës 5. 7. 2011 pa vërejte.

3. Raportim i ministrit të Punëve të Brendshme, z. Bajram Rexhepi

Kryetari – E falënderoi ministrin që iu përgjigj ftesës dhe për dërgimin e raportit me shkrim. Tha se në bazë të Planit të Veprimit të Kuvendit, ministri i Punëve të Brendshme e njofton rregullisht Komisionin për angazhimet që janë në përgjegjësinë e tij, si menaxhimi i integruar i kufirit, riatdhesimi dhe riintegrimi i personave të kthyer, azili dhe migrimi dhe çështjet e tjera që ndërlidhen me këtë Ministri.

Bajram Rexhepi – E falënderoi Komisionin për Integritet Evropian. Theksoi se interesi nacional ka bërë që të mos kemi dallime partiake. Për arsye se e kemi dorëzuar raportin

me shkrim ne nuk do të marrim shumë kohë, do të flasim për fushat që lidhen më shumë me plotësimin e kriterëve dhe në mënyrë të drejtpërdrejt që lidhen me plotësimin e kriterëve për liberalizimin e vizave. Sa i përket menaxhimit të integruar të kufirit është arritur progres i dukshëm. Ekzistojnë tri agjenci kryesore që merren me çështjen e menaxhimit të integruar të kufijve: Doganat e Kosovës, Policia Kufitare dhe Agjencia i Ushqimit dhe Veterinës.

Për zbatimin e Ligjit për menaxhimin e integruar dhe për kontrollin e kufirit shtetëror janë miratuar 7 (shtatë) udhëzime administrative. Në procedurë të ndryshimit dhe të plotësimit është edhe Ligji për menaxhimin e integruar dhe për kontrollin e integruar të kufirit shtetëror, që pritet të përcillet në Qeveri për procedurë të mëtutjeshme për miratim.

Regjistrimi i hyrje-daljeve në pikat kufitare është i lidhur me sistemin qendror elektronik BMS, që është kompatibil me sistemin e SIS-it të Shengenit. Jemi pajtuar që të gjitha të dhënat e njërit sistem t'i shkojnë edhe sistemit tjetër. Kështu aplikohen të dy këto sisteme. Pra janë harmonizuar qëndrimet sa i përket aplikimit të këtyre sistemeve. Vitin e kaluar Policia Kufitare e ka marrë përgjegjësinë komplet nga KFOR-i, sa i përket Shqipërisë dhe Maqedonisë. Nga 3 shtatori pritet ta marrim përgjegjësinë nga KFOR-i edhe për kontrollin me Malin e Zi, dhe gjatë pjesës së dytë të vitit pritet të bëhet edhe demarkacioni. Kështu që do të mbetet vetëm kufiri me Serbinë jashtë përgjegjësisë sonë. Sa i përket parandalimit të kontrabandës dhe krimit të organizuar pikat kufitare 1 dhe 31 janë të ndjeshme. Në këto dy pika bëhet regjistrimi i hyrje-daljeve, po ashtu bëhet edhe regjistrimi i mallrave. Si rezultat i kësaj është zvogëluar kontrabanda, por jo në nivelin e duhur. Në pikat 1 dhe 31 kemi patrulla të përbashkëta mobile të Policisë dhe të KFOR-it. Në prill është nënshkruar marrëveshja me Maqedoninë për patrullime të përbashkëta në kufi. Me Shqipërinë janë tri protokolle të nënshkruara dhe gjatë sezonit veror bëhet vetëm një ndalim. Sa i përket menaxhimit të kontrolluar të kufirit qëndrojmë relativisht mirë, kurse sa i përket riintegrit, kohë më parë e kemi kryer punën lidhur me legjislacionin. Sa për informim kemi lidhur marrëveshje me disa shtete. Tash së fundi kemi lidhur marrëveshje me Mbretërinë e Danimarkës, me Malin e Zi dhe me Çekinë. Deri në fund të vitit do të përmbyllem diku rreth 20 marrëveshje të nënshkruara për ripranim, kryesisht me ato shtete ku kemi një numër më të madh të qytetarëve tanë, që nuk e kanë të rregulluar statusin legal të qëndrimit. Sa i përket strategjisë për riintegrim, plani veprues - operacionalizimi i tij është kryer. Në grupin ndërministror ekziston bordi për implementimin e strategjisë për riintegrimin. Aty ekziston një sekretariat që e bën punën teknike. Në nivelin komunal zyrat për kthim dhe komunitete janë përforcuar mjaft shumë. Për këtë qëllim janë mbajtur trajnime me trajnerë të certifikuar që kanë bërë punëtori me 250 punonjës komunalë në komuna të ndryshme, në mënyrë që këto zyra të marrin më shumë përgjegjësi për destinimin dhe akomodimin e tyre nëpër komuna. Këto zyra në fillim kanë qenë shumë të dobëta. Tani, me angazhimin e kryeministrit, të ministres për integritet, së bashku me ne, kemi arritur t'i forcojmë këto zyra, si dhe të kemi progres sa i përket çështjes së riatdhesimit dhe riintegrit. Mendojmë se misioni vlerësues që do të vijë në shtator do ta japë një vlerësim pozitiv. Fondi i ndarë është rreth 3.4 milionë. Një numër i madh i kërkesave për mjete, si për gjëra ushqimore, sanitare, akomodim, etj., kanë ardhur nga niveli komunal. Një numër i madh i tyre janë realizuar. Procedura e realizimit të këtyre kërkesave është e shpejtë. Në nivelin komunal ende nuk kanë

kapacitete të mjaftueshme për të bërë projekte afatgjatë të realizueshme për personat e riatdhesuar. Ky fond duhet të shpenzohet konform Ligjit për menaxhimin e buxhetit. Nuk duhet vetëm të jepen fonde, por duhet të ketë arsyeshmëri për to. Sidomos në disa komuna, ku pritet numër më i madh i të kthyerve, duhet të jepen fonde për ndërtimin e banesave kolektive dhe për riparimin e tyre. Me rëndësi është të theksohet se për çështjen e integritetit do të zhvillohet një kampanjë për informim të qytetarëve. Është shpallur tenderi për këtë çështje dhe shumë shpejt pritet të përmbyllet i gjithë procesi për riintegrim. Kjo kampanjë do të jetë produktive. Ajo do të shfaqet në televizionet tona nacionale, në mediat e shkruara dhe do të organizohen vizita nëpër komuna, në mënyrë që të informohen qytetarët se koha e azilit ka përfunduar. Në përgjithësi mund të themi se në departamentet edhe në Zyrën për Riintegrim janë bërë përgatitjet e duhura. Në faza të ndryshme ka pasur një numër të konsiderueshëm të azilkërkuesve në Kosovë. Në vitin 2009 kanë qenë diku rreth 50 persona, në vitin 2010 mbi 200 persona, kurse këtë vit i kemi pasur 47 persona. Gjatë fazës së intervistimit shumica prej tyre janë deklaruar se kanë synim të shkojnë në vendet e BE-së. Konform Ligjit për azilin disa e kanë fituar të drejtën e azilit, kurse disa u është refuzuar azili. Në Magurë të Lipjanit pritet të përfundohet një qendër me standarde evropiane, me kapacitet për 50 vetash, për këta persona.

Kryetari – Tha se ka dy çështje për t'u sqaruar: *e para* kur pritet të vijë misioni vlerësues i komisionarit të Punëve të Brendshme, që është kritik për Udhërrëfyesin e liberalizimit të vizave; dhe *e dyta* ka të bëjë me atë që ju e keni paralajmëruar, përfundimin e regjistrave civilë, që është bazë për prodhimin e pasaportave biometrike. Nëse mund me të sqaroni deri ku keni mbërritur me këtë çështje, që është në interes të Komisionit dhe të publikut?

Bajram Rexhepi – Pohoi se ka pasur një komision vlerësues në dhjetor të vitit të kaluar nga Komisioni Evropian, përkatësisht nga Komisioni për Punë të Brendshme. Raporti ka qenë kritik për nivelin komunal, por më tepër për zyrat për kthim dhe komunitete. Është vërejtur një interesim jo i duhur i kryetarëve të komunave dhe për këtë arsye kemi organizuar një takim me kryetarët e komunave. Ne ia kemi dërguar një letër Komisionarit për Punë të Brendshme. Komisioni vlerësues i tyre është i gatshëm të vijë rreth mesit të shtatorit. Mirëpo edhe në takimin e djeshëm me eurodeputeten Lunaçek jemi shprehur të gatshëm për bashkëpunim, në mënyrë që raporti të dalë pozitiv dhe do të hapte rrugë për dialog dhe udhërrëfyes. Ne jemi relativisht mirë të përgatitur. Nuk mund të jemi perfekt, por mendojmë se vlerësimi do të jetë pozitiv dhe do të hapet rrugë për ecje të mëtutjeshme. Nuk e dimë se cilat komuna do t'i vizitojë ky mision, sepse nuk na tregojnë. Pra të gjitha komunat duhet të jenë të përgatitura. Njerëzit që janë kthyer, pa marrë parasysh cilit komunitet i përkasin, nuk janë të kënaqur me kushtet, sepse synojnë të shkojnë përsëri në vendet nga janë kthyer. Sa i përket regjistrimit civil, është një prej kryesoreve për liberalizimin e vizave. Aty përfshihen edhe siguria e dokumenteve civile dhe personale, natyrisht edhe regjistri civil qendror dhe libri i regjistrimit civil. Një numri i madh i librave amzë gjenden në Serbi. Ne kemi gjetur dy libra amzë. Disa prej tyre janë riparuar e disa të tjerë janë krijuar që nga fillimi. Pra, në bazë të të dhënave, i kemi krijuar librat amzë nëpër komuna. E kemi filluar procesin e pranimit të tyre dhe përgatitjen e procesit civil, që ka filluar në tetor të vitit të kaluar nga stafi i Departamentit për Regjistrim Civil. Ky pranim na ka kushtuar diku rreth 300 mijë euro, kurse Shqipëria

ka shpenzuar rreth 4 milionë euro më shumë. Ne e kemi pasur përvojën e Shqipërisë dhe stafin e përgatitur. Ditën e djeshme, zyrtarisht, çdo libër amzë që ka qenë nëpër komuna të Kosovës është skanuar, kurse digjitalizimi është proces i cili vazhdon edhe më tutje. Në përgjithësi kanë qenë rreth 13400 libra amzë, ma tepër se 2 milionë faqe. Disa prej tyre kanë qenë të dëmtuara edhe disa kanë qenë me alfabet cirilik, për të cilat është dashur të angazhohen përkthyes. Për ne ky proces ka përfunduar, edhe pse ky proces nuk mund të konsiderohet i përfunduar asnjëherë, sepse gjithmonë futen të dhëna të reja. Gjatë dialogut me Serbinë, dihet që janë pajtuar t'i marrim librat amzë nga Serbia të certifikuara dhe do të përdorim vetëm për t'i krahasuar me dokumentet tona, me qëllim që aty ku mungojnë të dhënat të kompletohen. Pra, regjistri civil qendror është bazë kryesore për prodhimin e pasaportave biometrike, sepse të dhënat janë shumë të kompletuara dhe ekziston një komunikim i vazhdueshëm nga niveli qendror me komunat.

Vjosa Osmani – Dihet se edhe po të kemi raport pozitiv të komisionit vlerësues për Kosovën, prapëseprapë më i rëndësishëm do jetë vendimi i Këshillit të Ministrave, përkatësisht rolin kryesor e kanë ministrat e brendshëm të BE-së. Gjatë vizitave në Parlamentin Evropian dhe në Komisionin Evropian është thënë se duhet të bëhet një punë më e madhe me ministrat e brendshëm, sepse pritet vendimi i tyre përfundimtar. A keni ndonjë plan që ta intensifikoni aktivitetin lobues me ministrat e brendshëm të BE-së në koordinim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe atë për Integritet Evropian? Pyetja e dytë ka të bëjë me kthimin e gjykatave në Veri. Edhe pse dihet që ka pasur shumë probleme, gjykatat në Veri kanë funksionuar edhe më parë. A keni marrë ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë, nga gjykatat apo nga institucionet e tjera gjyqësore për t'iu ofruar atyre siguri. Ne kemi mësuar nga disa deklaratat të EULEX-it, se duhet të merret leje nga Serbia për gjykatat në Veri. Nëse mund të na njoftoni sa është e vërtetë kjo?

Bajram Rexhepi - Ky proces nuk varet krejt nga komisionarja Malstrom, por edhe nga ministrat e brendshëm. Disa vende i kanë bashkë Ministrinë e Drejtësisë me atë të Brendshmen. Siç dihet vitin e kaluar kanë qenë katër shtete, që kanë njoftuar për këtë. Ato kanë qenë skeptike sa i përket çështjes së liberalizimit të vizave. Ne jemi në kontakt me këto shtete nëpërmjet ambasadorëve të tyre në Kosovë. I kemi të ndara detyrat tona me Ministrin e Punëve të Jashtme dhe me Ministrin e Integritet Evropian. Këto të dyja e kanë në kompetencë më tepër çështjen e lobimit. Ne, çdoherë, me kërkesë të tyre i informojmë se ku kemi mbërritur me procesin. Shtetet që deri tash kanë shprehur skepticizëm, besojmë se kanë ndërruar mendje. Mund të dalë që ndonjë shtet të jetë skeptik, sidomos ato ku mund të rritet numri i azilkërkuarëve. Sa i përket gjykatave në Veri, pas vitit 2008, jemi të mashtruar, sepse na është thënë se do të jetë një periudhë e shkurtër dhe gjykatat atje do të jenë funksionale. Nga një fond i USAD-it është bërë riparimi i Gjykatës Rajonale në Veri. Kthimi i funksionimit të gjykatave atje është një çështje më komplekse. Nuk mund të themi se siguria nuk është problem, por kemi ngritur kapacitetet për ta siguruar edhe atë pjesë. Ne jemi të gatshëm që çdoherë kur na kërkohet të ofrojmë siguri. Këtë do ta bëjmë së bashku me EULEX-in. Fundja e kemi obligim kushtetues dhe ligjor. Çështja se a kërkohet leja nga Serbia, për është e papranueshme. Në këto gjykata punojnë gjashtë gjyqtarë dhe prokurorë dhe një pjesë e stafit civil ndërkombëtar, kurse nga vendorët nuk ka as serbë, as shqiptarë. Këta të fundit janë të gatshëm të kthehen. Nga komuniteti serb ka pasur raste që pasi e kanë dhënë betimin,

kanë dhënë dorëheqje për arsye të frikësimit nga grupet e ndryshme kriminale. Natyrisht që ne kemi qenë sfidues për EULEX-in, sepse në një vend ku nuk sundon rendi dhe ligji ekziston anarkia. Mendojmë se edhe vetë qytetarët e komunitetit serb janë të interesuar që të kenë jetë të qetë në një vend ku sundon rendi dhe ligji. Ne kemi pasur një takim me zëvendëskryeministrin dhe me Ministrinë e Drejtësisë, kryeprokurorin, me Këshillin Gjyqësor dhe me të tjerë që sa më shpejt të ngrihet kjo çështje dhe të bëhet kërkesa për të ofruar siguri dhe jemi të gatshëm ta bëjmë këtë aty ku kemi kapacitete. Çështja e sigurisë nuk duhet të jetë njëra prej arsyeve për mosfunksionim të ligjit. Ne jemi të përkushtuar që në këtë pjesë të funksionojë ligji dhe rendi, por kërkesë për të ofruar siguri nuk ka ardhur deri me tani.

Alma Lama – Së pari e falënderoj ministrin për raportin. Është hera e parë që një ministër të sjellë një raport me shkrim. Po ashtu ka pasur probleme në kufij, sa i përket numrit të të kthyerve nga disa shtete. Ju po ashtu folët për një rritje të kontrollit të mallrave dhe të njerëzve në pikat kufitare ku kalojnë mallra nga Kosova në Serbi dhe anasjelltas. Sidoqoftë do të doja të na informoni më sakët për këtë ngritje të kontrollit. Cilat janë masat që janë ndërmarrë, sa ka qasje Policia e Kosovës në pjesën Veriore, duke marrë parasysh dorëheqjen e stafit serb? Kërkojmë të na informoni në lidhje me policinë në këtë pjesë. Disa kriminelë janë arrestuar, por janë liruar menjëherë. Pyetja e dytë ka të bëjë me krimin e organizuar dhe me korrupsionin. Ç'po bëhet me rastin e vjedhjes në Dhomën e Dëshmive? Pyetja e tretë ka të bëjë me mungesën e buxhetit, me rastin e mbrojtjes së informatorëve ose me luftën ndaj krimeve ekonomike. Kërkojmë nga ju të na tregoni sa parashihet buxheti që ju nevojitet për këto çështje?

Bajram Rexhepi - E kemi dërguar paraprakisht raportin me shkrim, në mënyrë që t'ju njoftojmë juve si komisionin parlamentar. Sa i përket patrullimit me ato vende, si Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë, nuk kemi problem, përveç me pjesën tjetër që e kemi me Serbinë. Me Serbinë i kemi dy natyra të problemit. Njëri ka të bëjë me kontrollin fizik të kufirit, që ndryshon nga menaxhimi i integruar i kufirit. Kontrolli fizik këtu edhe më tutje bëhet së bashku me KFOR-in. Pra edhe më tutje kjo pjesë mbetet kompetencë e KFOR-it dhe nuk mund ta dimë se kur do të bëhet një transferim i kompetencave. Për menaxhimin e integruar të kufirit në hyrjen 1 dhe 31 në vitin e kaluar kemi filluar një plan dinamik. Sipas tij javën e parë duhej të kontrollohej çdo i gjashti automjet, në javën e dytë çdo i katërti, javën e tretë çdo i treti dhe i dyti dhe në fund çdonjëri. Sa u përket hyrje-daljeve një kontroll i tillë bëhet, edhe pse qind për qind kontrolli nuk mund të bëhet gati askund. Infrastrukturën e ka përgatitur Policia e Kosovës dhe të dhënat përcillen me anë të sateliti në zyrën qendrore. Kështu dihet sa ka pasur hyrje në këto dy pika kufitare. Sa u përket mallrave, aty bëhet regjistrimi i mallrave nga doganierët e EULEX-it, duke i drejtuar të shkojnë në terminal, por një gjë e tillë qind për qind ende nuk realizohet. Sa i përket Policisë Kufitare, në këtë pjesë, kemi më shumë pjesëtarë të komunitetit serb. Në këtë pjesë i kemi tri zona: veri, lindje dhe jug. Sa u përket stacioneve policore ata kanë pasur rotacion, që është respektuar, me përjashtim të disa individëve. Në Veri pjesëtarët e policisë janë kryesisht të komunitetit serb. Nuk duhet të jetë breng, pse ata janë të këtij komunitetit, por sa e respektojnë zinxhirin komandues. Deri tash relativisht mirë e kanë respektuar zinxhirin komandues, kurse rotacioni ose ndërrimi i vendeve të punës, nuk ka qenë vendim politik, por është bërë në

krejt Kosovën. Katër prej komandantëve rajonalë të stacioneve policore janë ndërruar në Veri të Kosovës, por kanë ndërhyrë kuvendet ilegale të pjesës Veriore, që pretendojnë se duhet të pyeten. Ata janë ilegalë dhe nuk mund të jenë partnerë. Ata që nuk ju kanë bindur urdhrave dhe hierarkisë, pas të gjitha procedurave që janë kryer, janë shkarkuar nga detyra. Sa u përket kriminelëve janë arrestuar individë të caktuar pa paragjykuar. Prokurorët kanë shkuar nga ajo që për të burgosur dikë duhet të këtë fakte të qindpërqindta, por shpeshherë është e pamundshme të sigurohen prova në atë shkallë. Tash ka filluar të ndërrohet qasja dhe shpresojmë të rritet efikasiteti i prokurorëve dhe i gjyqtarëve. Hetuesit e EULEX-it nuk kanë shprehur gatishmërinë e bashkëpunimit me hetues vendorë. Sa i përket vjedhjes së dëshmive, fatkeqësisht, pas një periudhe disamujore, nuk ka pasur rezultate të prekshme. Ky rast i ka kaluar EULEX-it, sepse është menduar se ata kanë eksperiencë më të mirë dhe kanë kapacitete për këtë vjedhje të nivelit të lartë. Lëndën e kanë mbajtur më shumë se një vit e gjysmë dhe kanë kërkuar që afati ligjor të shtyhet edhe pak. Ne i kemi shkruar letër z. Marnak për ta njoftuar deri ku ka mbërritur EULEX-i me hetimet për të zbuluar këtë rast. Kemi kërkuar që rasti të na kthehet neve nëse ata nuk mund zgjidhin. Po ashtu ne kemi propozuar një formë të përbashkët të hetimeve për rastin e vjedhjeve në Dhomën e Dëshmive në polici. Kemi menduar se dikush nga niveli i lartë është i përfshirë në këtë vjedhje. Si duket këtë e kanë bërë bandat kriminale. Njerëzit që japin informata duhet të shpërblehen, siç bëhet edhe në vendet e tjera. Është më rëndësi se kush i cakton ato shpërblime dhe si të menaxhohet ky fond. Kjo është dashur të bëhet nga Kuvendi ose nga një komision i veçantë, në mënyrë që të mos keqpërdoret ky fond. Sa u përket krimeve ekonomike dhe të organizuara janë ngritur më se 20 hetime. Priten rezultatet nga njësia që është e profilizuar për ndjekjen e këtyre krimeve. Kërkohen fonde për ta bërë rekrutimin e një numri më të madh të ekspertëve, për teknologjinë e re, si dhe për përgjimet e telefonave, për të cilën gjë në fillim ka qenë një marrëveshje me *Valën*, kurse më vonë është bërë edhe me *Ipkon*. Sa i përket fondit nuk mund të dihet saktë sa duhet të jetë, sepse ai është konfidencial dhe duhet të përfshihet në planifikimet buxhetore.

Blerim Shala – Ju si ministër dhe kryeministri ka një vit që keni qenë të sigurt se do ta merrni strategjinë për liberalizimin e vizave. Si datë të fundit e keni caktuar shtatorin ose tetorin e vitit të kaluar, kurse një vit më vonë ende nuk jeni të sigurt se do ta merrni Strategjinë për liberalizimin e vizave për Kosovën.

Bajram Rexhepi – Keni plotësisht të drejtë, sepse ne kemi qenë shumë optimist, kurse tani nuk u besojmë. Premtimet kanë qenë të mëdha vitin e kaluar. Pierre Mirel pati premtuar se Kosova do ta marrë Strategjinë për liberalizimin e vizave në muajin shtator të vitit 2010, por deri më sot kjo nuk ka ndodhur. Presion i madh është bërë të ministrat e disa shteteve, ku ka pasur numër më të madh të azilkërkuesve, sidomos të disa vende si Gjermania, Suedi dhe Franca. Kosova e ka përgatitur vet një udhërrëfyes, duke i marrë parasysh ato që kanë qenë për vendet e rajonit. Madje disa vende në rajon kanë filluar t'i përmbushin kriteret vetëm disa muaj më parë. Në fund i kemi thënë BE-së se Udhërrëfyesin po e kushtëzon me dialogun me Serbinë. Kjo nuk është e drejtë, sepse ai duhet të jepet në bazë të meritave dhe të plotësimit të kriterëve që kërkohen.

Albert Kinolli – Sa jeni të kënaqur me bashkëpunimin e Ministrisë suaj dhe me institucionet e tjera, si me KFOR-in, me Zyrën e ICO-së, me EULEX dhe me UNMIK-un.

Bajram Rexhepi – Për të mos i përsëritur ato që i thashë më parë do t'i bie shkurt. Me KFOR-in kemi bashkëpunim të mirë. Ai është shprehur i gatshëm të përkrahë Policinë e Kosovës dhe EULEX-in, sa herë që kërkohet një gjë e tillë. Me EULEX-in herë kemi bashkëpunim, herë jo, ndërsa sa i përket UNMIK-ut nuk kemi bashkëpunim. Ai formalisht është këtu. Jemi të befasuar kur kemi dëgjuar për aprovimin e një buxheti prej 40 milionë dollarësh për ta vazhduar edhe një vit misionin. UNMIK-u nuk ka asnjë funksion operacional, as lehtësues, përpos që i bën disa raporte për situatën në Kosovë. Në kohën e Shtajnerit është marrë një vendim që UNMIK-u, me një lloj këshilli multi-etnik, të administrojë në Veri deri në themelimin e komunës dhe deri në mbajtjen e zgjedhjeve në atë pjesë. UNMIK-u për ne është këtu i tepërt. Mendojmë se ai më shpejt duhet të shkojë nga Kosova.

Xhavit Haliti – E falënderoj ministrin për raportim. Për raportin me shkrim, pavarësisht disa vërejtjeve në tekst, dua të vë theksin te të kthyerit nga jashtë dhe ta ndërlidh me çështjen e azilkërkuesve. Siç dihet në shtetet evropiane personat që kërkojnë strehim kthehen detyrimisht në shtetin e parë që shkelin. Nëse mund të na tregoni a ka Kosova me ndonjë vend sistem të vizave, apo mund të hyjë çdo kush që ka një dokument me një fotografi? Dihet se nga cilët shtete vijnë refugjatët, që e shfrytëzojnë Kosovën për të depërtuar në vendet evropiane dhe pyetja është nëse Kosova e aplikon sistemin e vizave me ndonjë vend. Nga ato shtete duhet të kërkojmë të mos e shfrytëzojnë Kosovën si urëkalimi për të kaluar dhe për t'u strehuar në vendet evropiane.

Bajram Rexhepi – Për ta parandaluar migracionin ilegal, përveç masave të tjera në kufi, duhet të zbatohet një regjim i vizave. Në bazë të ligjit për azil dhe shtetësi, qysh vitin e kaluar kemi dashur ta aplikojmë një regjim të vizave. Kemi menduar se ndoshta te shtetet që nuk na kanë njohur, për shkak të personave që vijnë nga ato shtete, do të ndikojmë në qëndrimin e tyre për njohjen e shtetit të Kosovës. Për ta nxjerrë një urdhëresë administrative për regjim të vizave vendimi duhet të vijë nga Ministria e Punëve të Jashtme. Regjimi i vizave duhet të jetë konform me rregullat e shteteve të BE-së dhe vizat do të vendosen për ato vende që i vendos BE-ja, me përjashtim të disa shteteve që kemi marrëveshje bilaterale. Problem paraqesin edhe furnizimi me viza dhe lloji i vizave. Ne nuk kemi konsullata në shumë vende, prandaj duhet të përdorim mundësinë, që të aplikojmë nëpërmjet vendeve ku kemi përfaqësi si në Turqi - Ankara, ose të kërkojmë ndihmë konsullore nga Shqipëria ose nga Maqedonia e vende të tjera. Kjo ndihmon pastaj në parandalimin e qarkullimit ilegal.

Kryetari – E falënderoi ministrin për raportimin para Komisionit. Tha se në të ardhmen presim bashkëpunim që mbledhja të vazhdojë sipas rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-011 për organizimin sindikal në Kosovë, me amendamentet e komisionit funksional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetari – E ftoi deputeten Alma Lama, referuese e këtij Projektligji, ta paraqesë raportin për këtë Projektligj.

Alma Lama – Pas shqyrtimit konstatuam se ky Projektligj, së bashku me amendamentet e komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE- së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji me nr. 04/L-011 për organizimin sindikal në Kosovë, me amendamentet e komisionit funksional, është në harmoni me Acquis Communautaire.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-014 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, me amendamentet e komisionit funksional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetari – E ftoi deputetin Sasha Milosavljeviq, referues i këtij Projektligji, ta paraqesë raportin për këtë Projektligj.

Sasha Milosavljeviq – Pas shqyrtimit konstatuam se ky Projektligj, së bashku me amendamentet e komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji nr. 04/L-014 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, me amendamentet e komisionit funksional, është në harmoni me Acquis Communautaire.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-26 për markat tregtare, me amendamentet e komisionit funksional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetari – E ftoi deputetin Albert Kinolli, referues i këtij Projektligji, ta paraqesë raportin për këtë Projektligj.

Albert Kinolli – Pas shqyrtimit konstatuam se ky Projektligj, së bashku me amendamentet e komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji me nr. 04/L-26 për markat tregtare me amendamentet e komisionit funksional, është në harmoni me Acquis Communautaire.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-29 për patenta, me amendamentet e komisionit funksional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetari – E ftoi deputetin Albert Kinolli, referuese e këtij Projektligji, ta paraqesë raportin për këtë Projektligj.

Albert Kinolli – Pas shqyrtimit konstatuam se ky Projektligj, së bashku me amendamentet e komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji me nr. 04/L-29 për patenta, me amendamentet e komisionit funksional, është në harmoni me Acquis Communautaire.

8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-28 për dizajnin industrial, me amendamentet e komisionit funksional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetari – E ftoi deputetin Albert Kinolli, referues i këtij Projektligji, ta paraqesë raportin për këtë Projektligj.

Albert Kinolli – Pas shqyrtimit konstatuam se ky Projektligj, së bashku me amendamentet e komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji me nr. 04/L-28 për dizajnin industrial, me amendamentet e komisionit funksional, është në harmoni me Acquis Communautaire.

9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-22 për përdorimin civil të eksplozivëve, me amendamentet e komisionit funksional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetari – E ftoi deputeten Suzana Novoberdali, referuese e këtij Projektligji, ta paraqesë raportin për këtë Projektligj.

Suzana Novoberdali – Pas shqyrtimit konstatuam se ky Projektligj, së bashku me amendamentet e komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji me nr. 04/L-22 për përdorimin civil të eksplozivëve, me amendamentet e komisionit funksional, është në harmoni me Acquis Communautaire.

10. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/ 249/L-013 për kadastër, me amendamentet e komisionit funksional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetari – E ftoi deputeten Blerta Deliu-Kodra, referuese e këtij Projektligji, ta paraqesë raportin për këtë Projektligj.

Blerta Deliu-Kodra – Pas shqyrtimit konstatuam se ky Projektligj, së bashku me amendamentet e komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji me nr. 04/ 249/L-013 për kadastër, me amendamentet e komisionit funksional, është në harmoni me Acquis Communautaire.

11. Informatë shtesë për rishqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, me amendamentet e komisionit funksional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetari – Edhe një herë e kemi në shqyrtim këtë Projektligj, për të dhënë informata shtesë, prandaj hapi debatin për të.

Vjosa Osmani – Tha se duhet të ekzistojë hierarkia e akteve ligjore, sepse në këtë Projektligj kemi nene me përmbajtje të kundërt.

Blerim Shala – Tha se nuk mund të bëhet ndryshimi i Ligjit pa u bërë ndryshimi i Kushtetutës.

Kryetari – Konstatoj se Komisioni mori qëndrim që vendimi i Komisionit të datës 5. 7. 2011 të mbetet në fuqi.

12. Diskutim lidhur me hartimin e raportit të parë të Progresit të Planit të Veprimit të Kuvendit për integrim evropian për vitin 2011

Kryetari – Njoftoj se stafi mbështetës i Komisionit, së bashku me koordinatorët e komisioneve të tjera, e kanë përgatitur një draft të këtij Raporti. Për javën e ardhshme kërkojmë që të jepen propozime konkrete, në mënyrë që të miratohet dhe të procedohet për miratim në Kuvend.

13. Të ndryshme.

Kryetari – E njoftoi Komisionin që për mbledhjen e radhës të ftohet Ministri i Drejtësisë për të raportuar para Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Lutfi Haziri